

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Për:</b>	<b>Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës</b> <b>Vjollca Konjusha, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës</b>	
<b>Cc:</b>	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
<b>Nga:</b>	Venera Çerkini, U.D e Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 04/04/2019 Nr.020-206
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Fushë Kosovës	
<b>Lloji i aktit:</b>	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.43 për fillimin e procedurave për ndërtimin e objektit me destinim Repart për riciklimin e gomave të përdorura të automjeteve.


I miratuar më datë: 22.02.2019

I parashtruar në MMPH nga MAPL me datë 05.03.2019 si dhe pas kthimit të përgjigjes nga MMPH në MAPL me datë 29.03.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit nga MMPH-së, e cila ka vlerësuar se nuk është kompetente për shqyrtimin e këtij akti aktin e ka vlerësuar vetëm në aspektin procedural dhe konstaton se **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

*Ndërsa sa i përket procedurave të mëtejme për pajisjen me leje dhe licenca për zbatimin e këtij vendimi mbetet në kompetencë të komunës së Fushë Kosovës si dhe palëve në këtë vendim të aplikojnë dhe zhvillojnë procedurat në harmoni me legjislacionin në fuqi.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	<b>Burim Berisha</b> , gradonačelnik Opštine Kosovo Polje <b>Vjollca Konjusha</b> , predsedavajuća Skupštine opštine Kosovo Polje
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u, Jedinici za administraciju dokumenata u opštini,
Preko:	<i>ZA</i> <b>Ivan Todosijević</b> , ministar MALS-a, <i>B. Kuzin</i> <i>pe</i> <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MALS-a, <i>Begolli</i>
Od:	<b>Venera Çerkini</b> , v.d rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS Datum, 04.04.2019.
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Kosovo Polje 020-206
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine

Poštovani gradonačleniče,  
Poštovana predsedavajuća

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br.43, za početak procedura za izgradnju objekta sa namenom u Repart za reciklovanje istrajalih automobilskih guma.
Usvojena dana, 22.02.2019.
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 10.04.2018. godine,
Preložena za razmatranje u MSPP-u od strane MALS-a dana, 05.03.2019 kao i vraćanja odgovora od strane MSPP-a u MALS dana, 29.03.2019

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja akta od strane MSPP-a koje je ocenilo da nije nadležno za razmatranje ovog akta, ocenilo je akt samo sa proceduralnog aspekta i utvrdilo je da je u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.

Što se tiče daljih procedura za izdavanje dozvola i license za primenu ove odluke, ostaje u nadležnosti opštine Kosovo Polje, kao i strana u ovoj odluci da primenjuju i razvijaju postupke u skladu sa zakonodavstvom na snazi.

Ministarsvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORATI I ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO

Nelaj/Pr. sh. 43  
Data/Data 28. 02. 2019  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Datë: 26.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 483, të datës 14.12.2018, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projektimit, lidhje me Kërkesën Nr. 05-345/03-0040174/18 të datës 11.12.2018, paraqitur nga kompania "TRANS LTD SHPK" - përfaqësuar nga Dimitros (Panagiotis) Dedovsis nga Athina, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Rezolutën Administrative për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nënli 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

Administratë e Pushtetit Lokal  
Government Administration

28.02.2019

Procedura	Nr. i Lendës	Objekti	Vlera
07	020-206		

**VENDIM**

**Për fillimin e procedurav për ndërtimin e objektit me destinim 'Repart për riciklim të gomave të përdorura të automjeteve'**

1. Për fillimin e procedurav për ndërtimin e objektit me karakter të përkohshëm (konstruksion montues), në ngastrën kadastrale Nr. P-72514014-00134-10 në sipërfaqe prej S=5358.0m<sup>2</sup> në pronësi të z. Skënder Breznica në Zonën Kadastrale Miradi e Epërme nga pala 'DECO TRANS LTD SHPK' me destinim 'Repart për riciklim të gomave të përdorura të automjeteve'.
2. Zbatimi i këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Projektimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PUP, Drejtorisë së Inspektoratit, Palës dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTERIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPESINOR  
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Organi: DL  
 Nr. i fletës: 02  
 Nr. Prot. / Prot. No: 1177-2/19  
 Data / Datum: 29.03.19

Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

HYRESE-ULAZNA-INCOMING  
 REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum: 29.03.2019

Organizata	Sir i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	020-206/8		

Për :	Ivan Todosijeviq, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Cc:	Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
Përmes:	Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së	
Nga:	Vlora Osaj, u.d.Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Datë: 20.03.2019
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Përgjigje në kërkesë	

I nderuar Ministër,  
 E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim kërkesën nr.prot. 020-206/1 dhe jap përgjigjen si në vijim:

**Vendimi i Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës Nr. 43 , datë 26.02.2019,  
për fillimin e procedurave për ndërtimin e objektit me destinim „ Repart për  
riciklim të gomave të pë përdorura të automjeteve”.**

I miratuar me datë: 26.02.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:28.02.2019

I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 05.03.2019

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se **nuk është kompetente** për shqyrtimin e aktit të komunës lidhur me këtë çështje.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë përgjigje dhe vlerësim.